



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

## F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e VII-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 09.07.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

## R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 07.06.2024,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-qershor 2024 (ref.drejt.fin),
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2023 (ref.ekz),
5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit (ref.ekz)
6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë 25.06.2024,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt qershor - korrik 2024,
8. Të ndryshme.

01Nr. 06-20262 2024  
Klinë, më 03.07 2024



Kryesuesi  
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Pozivajući se na član 52. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, član 33 Statuta opštine Klina, članovi 15 i 16 i 17 Poslovnika o radu Skupštine i opštinskih odbora, predsednik komiteta za politiku i finansije opštine Klina, vrsi sledece:

### OBAVESTENJE

Pozivaju se svi članovi Odbora za politiku i finansije da učestvuju na 7. sastanku KPF-a koji se održava: 09.07.2024. godine u sali Skupštine opštine Klina, sa početkom u 09:00 časova..

### DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sastanka održanog 07.06.2024.
3. Pregled izveštaja o finansijskom upravljanju januar-jun 2024. (ref. direct.fin),
4. Razmatranje revizorskog izveštaja za godišnje finansijske izveštaje opštine Klina za 2023. godinu (ref. Finans.),
5. Pregled akcionog plana za implementaciju preporuka revizora (ref. npr.)
6. Razmatranje zapisnika sa sastanka sa građanima održanog od strane gradonačelnika dana 25.06.2024.
7. Razmatranje podnesenih zahteva Odboru za politiku i finansije za mesec jun - jul 2024. godine,
8. Razno.

01Br. 06-20868 2024  
Klina, 03.07 2024



Predsedavajući  
Fadil Gashi



Për: Komiteti për Politikë dhe Financa – KK Klinë

REPUBLIKA KOSOVA

Nga: Sejdi Baleci – Përfaqësues i Bashkësisë Lokale të Grabanicës

Subjekti: Kërkesë për ngritjen e bustit të heroit kombëtar Azem Bejta në Grabanicë

Datë: 04.06.2024

nr.

Organ...

Të nderuar,

04.06.2024  
CA 610-19492/24

Me këtë i drejtohem i këtij organi për dhënien e pëlqimit për ngritjen e bustit të heroit kombëtar Azem Bejta në Grabanicë.

Lusim organin që ta merr në shqyrtim këtë iniciativë dhe ta aprovojë, që të na ipet mundësia e vazhdimit dhe përfundimit të kësaj nisme me plot vlera historike dhe kombëtare.

Andaj, shumë të nderuar, neve si përfaqësues të qytetarëve të Bashkësisë lokale të Grabanicës, dhe përfaqësuesit të shkollës „Azem Bejta“ në Grabanicë, ju drejtohem i me Kërkesën, që edhe në rrugën zyrtare të na bëhet e mundur ngritja e bustit të heroit kombëtar Azem Bejta në lokacionin (oborrin) e shkollës „Azem Bejta“ në Grabanicë, komuna e Klinës.

Paraprakisht ju falënderojmë, dhe mirëpresim vendimin tuaj!

Grabanicë,

04.06.2024

Përfaqësuesi i shkollës:  
Drejtori, FADIL BERISHA



Përfaqësuesi i bashkësisë lokale  
të Grabanicës: SEJDI BALECI






REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Për/To/Za :	Komitetin për Politikë e Financa
Kopje :	Kuvendin Komunal
Nga/From/Od :	Drejtoria për Buxhet e Financa - z.Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	Z. Zenun Elezaj – kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për shqyrtimin e Raportit Financiar janar-qershor 2024
Data :	3.07.2024



Përshëndetje të nderuar!

Me anë të kësaj letre përcjellëse kërkojmë shqyrtimin e Raportit Financiar janar-qershor 2024 .

Me respekt!

REPUBLIKA KOSOVA	
OPŠTINA KLINA	
3.07.2024	
Nr. i org.	Org. Jed.
01	052-20838/24





**Kuvendi i Komunës Klinë**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

01Nr \_\_\_\_\_/24

Klinë,dt: \_\_\_\_\_/24

## **PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 07.06.2024, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.**

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorin e Financave, z. Enver Berisha, OSBE-në, policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

**Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:**

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 08.04.2024 dhe 20.05.2024,**
- 3. Shqyrtimi i draft-kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (Ref.drejt.fin.),**
- 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve brenda kategorisë ekonomike shpenzimet kapitale (Ref.drejt.fin),**
- 5. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për draft-strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 (Ref. nga grupi punues),**
- 6. Shqyrtimi i draft-strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 (Ref. nga grupi punues),**
- 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt maj-**

qershor 2024,  
8. Të ndryshme.

**Fadil Gashi, kryesues:** Asdreni më lajmëroj se është duke ardhur, përndryshe jemi 6 anëtarë. Ne mund të vazhdojmë me mbledhjen. A ka dikush për rend të ditës?

**Me 6 vota PËR u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsytimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Tek arsyetimi i mungesave, unë edhe njëherë po e konfirmoj se 6 anëtarë jemi prezentë, Asdreni është rrugës duke ardhur, besoj se na arrin.

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 08.04.2024 dhe 20.05.2024.**

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush për dy proceset? Kush është për?

**Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

**Pika 3. Shqyrtimi i draft-kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (Ref.drejt.fin).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Këtu e kemi drejtorin e Drejtorisë së Financave, që të na bëjë një prezantim. Gjithsesi, e di që ende është nëpër diskutime në fshatra të ndryshme, nëse dëshiron një prezantim të kornizës, drejtor, urdhëro!

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, drejtor, përshëndetje për anëtarët e KPF-së, për përfaqësuesit e OSBE-së, zyrës për komunitete! Realisht, tashmë është veç obligative që korniza afatmesme buxhetore të bëhet pjesë e debatit paraprakisht para se të vie në aprovim buxheti i vitit të ardhshëm kalendarik, edhe kjo ka filluar që më datën 31, dmth ekipet e Drejtorisë së Financave me drejtoritë tjera, bashkë me kryetarin e komunës veç kanë dal në terren me disa gjëra, fillimisht me bashkësinë lokale të Drenocit, Grabanicës dhe në Zajm, mandej është vazhduar me bashkësinë lokale të Ujmirit, Jashanicës dhe Gllarevës. Pjesë e debatit do të jenë



nga data 10 edhe zonat e tjera, siç janë: Budisalci, Zllakuqani, Jagoda, Sferka, kështu që, përmbillet me qytetin këtu në sallën e kuvendit dhe dmth përfundon faza e parë e dëgjimeve buxhetore për kornizën afatmesme buxhetore për kornizën vijuese.

Kështu që, pa dashur ta zgjas shumë, unë veç po i prezantoj ndryshimet ku janë tash nëpërmes viteve, për buxhetin që është planifikuar, dmth viti 2024 ky që jemi tash ka qenë prej të hyrave vetanake, planifikimi ka qenë 1 436 000 00, e që është tejkaluar për 424 000 00 euro ndërsa për vitin 2025 është 1 492 000 00, për vitin 2026 është 1 560 000 00; grantet dhe transferet qeveritare për vitin 2024-2026 kanë qenë 13 361 000 00 euro, tash janë 14 113 000 00 dhe për vitin 2026 janë 14 795 000 00 euro. Këto janë shpërndarë nëpër kategoritë të cilat ne i kemi këtu, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe subvencione si dhe zakonisht pjesa më e rëndësishme e shpenzimeve kapitale. Dmth për paga dhe mëditje për vitin 2024 ka qenë 7 838 000 00, ndërsa për vitin 2025 janë 8 000 000 00, dhe 8 430 000 00 për vitin 2026; në mallra dhe shërbime nga 1 710 000 00, për vitin 2025 janë 1 795 000 00 dhe për vitin 2026 1 856 000 00; për shërbime komunale në 2024 kanë qenë, 250 000 00 të planifikuara, në vitin 2025 janë 260 500 00, dhe në vitin 2026 janë 275 627 00; ndërsa subvencionet kanë qenë për këtë vit 500 000 00 ndërsa janë planifikuar për këtë vit nga korniza buxhetore që ka ardhur në nivelin buxhetor 5 550 00 euro, por këtu te investimi përdoret kjo shifër, besoj do të rritet dhe të shkojë deri në rreth 800 000 00, ndërsa për vitin 2026, planifikimi nga niveli qendror ka qenë 569 000 00 euro, por edhe kjo shifër prej 2026-ës do ndryshojë, që shpenzimet kapitale kanë qenë 4 500 000 00 euro për vitin 2024, 4 962 00 për 2025-ën dhe 5 200 000 00 për vitin 2026.

Kështu që, meqenëse është ende draft fillestar, mund t'i ketë ndryshimet e veta gjatë dëgjimeve publike dhe në fund ne do të dalim në dimensionin përfundimtar pasi t'i marr të gjitha konsultimet në terren, sikur që i kanë bërë vitin e kaluar, kurse ju që i keni dëgjuar edhe përfaqësuesin e DEMOS-it se gjatë dëgjimeve publike në vitin e kaluar mbi 80% e propozimeve që kanë dalë në terren nga debatet janë inkorporuar në projektet për ndërtim 2024. Kështu që, besoj që edhe kësaj here do të marrim shumë propozime edhe nga terreni dhe që këto t'i bashkohen një projektbuxheti që është i planifikuar për vitin 2025 dhe për vitin 2026. Kështu që, ne i mirëpresim debatet që i kemi edhe këtu edhe në terren, por në fund është asambleja ajo që në muajin shtator e jep vizën e draft-buxhetit për vitin 2025, faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit shumë, drejtor! A ka dikush? Urdhëro, Tunë Deda!

**Tunë Deda:** Përshëndetje, kryesues, për ju, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Drejtor, këtu që e keni paraparë, p.sh., ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore, p.sh., Gjurgjevik i Vogël, Klinafc, p.sh., i keni paraparë 50 000 euro, 30 000, 20 000, vitet nuk i keni vënë. A është për tri vite apo për një vit? Në cilin vit është paraparë?

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Për vitin 2025- 2026. Janë tri rubrika për shkak se mundet të dallojë projekti edhe pse është në atë zonë, dmth se ne e kemi infrastrukturë rrugore dhe nëntokësore e tash aty varësisht kah vijnë nevoja e vendasve aty, banorëve, mund t'i kanalizojmë këto mjete, po si total është ajo shumë të planifikohet për atë pjesë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që e njëjta të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 4 . Shqyrtimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve brenda kategorisë ekonomike shpenzimet kapitale (Ref.drejt.fin).**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, drejtori i FEZH kërkoi të bëhet transfer i mjeteve brenda OB nga kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale (kodi -300), fondi burimor 10.

Nga programi Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470), nën-programi Bujqësia-Klinë (47018), kodi funksional (0421) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Budisalc-Jagodë-Radulloç,Poterq-Dollove”, kodi i projektit (54346), shuma prej 19,847.00 €, të transferohet në:

Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisor (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)”, kodi i projektit (54341) shuma 9,763.00 €.

Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisor (660), nën-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës “Ymer Berisha”, “Drini i Bardhë”, “Skender Rexhepi”, “Abedin Rexha”, “Mehmet Haxhaj”, “Haxhi Zeka”, kodi i projektit (54272) shuma 1,781.13 €.

Programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nën-programin Shërbimet e shëndetësisë primare (74050) me kod funksional (0721) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “Ndërtimi i nxehjes qendrore me pompa termike në QKMF Klinë”, kodi i projektit (54361), shuma 6,000.00 €.

Programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën-programin Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik Krushevë e Vogël-Madhe, Drenoc, Qeskovë, Jashanicë, Leskoc, Ranoc”, kodi i projektit (54353), shuma 2,302.87 €.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit për transfer të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale, me 6 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**



**Pika 5. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për draft-strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 (Ref. nga grupi punues).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Urdhëro, drejtor!

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Po, faleminderit, kryesues! Drejtori i Administratës i cili ka pasur të referojë këtu, më njoftoj se është në gjykatë dhe nuk mund të mbërrij, por mu lut që t'i jap këto sqarime sepse komisioni e ka kryer punën e vet, debatet janë bërë dhe ky dokument është i harmonizuar edhe me nivelin qendror dhe unë rekomandoj që kjo të shkojë në asamble komunale dhe për asamble besoj drejtori do të jetë prezent dhe do ta prezantojë këtë rregullore.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, a ka dikush? Atëherë, kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për draft-strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 6. Shqyrtimi i draft-strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 (Ref. nga grupi punues).**

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt maj-qershor 2024.**

**Kërkesa 1.**

Kërkesë për regjistrim të këmbimit të pronës e parashtruar nga Stanka Bogiqeviq nga fshati Drenoc i Komunës së Klinës e cila thekson se, që nga viti 1966 shkolla fillore në fshatin Drenoc me marrëveshje për këmbim prone me prindin tim të ndjerë, është ndërtuar në një pjesë të pronës sime, por ajo pjesë e tokës juridikisht ende është në emrin tim, ndërsa toka që i është

dhënë si këmbim ende është në emër të kooperativës bujqësore “Bistrica” nga Drenoci. Andaj kërkon që të fillojnë procedurat ligjore për rregullimin e gjendjes faktike, pjesa e cila shfrytëzohet nga shkolla të kalojë në emër të shkollës, ndërsa pjesa e cila është në emër të kooperativës të kalojë në emrin e saj.

**Fadil Gashi, kryesues:** A po pajtoheni që ta dërgojmë këtë lëndë në Drejtorinë për Kadastër e le të merren ata me shqyrtimin e lëndës në detaje edhe me na kthyer një raport pastaj. Ata e kanë juristin, gjeodetët, kadastrën, arkivin, prandaj ata duhet me na pasqyruar me ndonjë dokument. Po, urdhëro, Tunë?

**Tunë Deda:** Kryesues, nuk është ky rast i vetëm, ka shumë raste të këtij lloji, por unë pajtohem shumë me ty, që kjo të shkojë së pari në Gjeodezi me këqyr çka aty të meta, pastaj me dërguar në kuvend. Unë se di as kuvendi që mund të sjell ndonjë vendim, përpos që në fund të fundit me pasur rrugë ligjore, se nuk e di a ka të drejtë komuna për një ndryshim që është bërë para 30 apo 40 vite me vendim për këmbim. Pajtohem me vendimin e juaj, që të shkojë njëherë së pari në gjeodezi, pastaj të vij njëherë në komitet muajin e ardhshëm edhe ne me dërguar në kuvend çka mundet me nxjerr.

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Stanka Bogiqeviq, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.**

## **Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga HANDIKOS, kryetarja Vjollca Preka, me anë të së cilës kërkojnë sigurimin e një objekti për aktivitetet dhe nevojat e tyre, një zyre 20m<sup>2</sup>, një sallë për takime dhe trajnime të ndryshme 25m<sup>2</sup> dhe një depo për mjete ortopedike dhe sanitare 20m<sup>2</sup>. Gjithashtu kërkojnë që të përkrahen vazhdimisht për plotësimin e kushteve dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të cilët janë mbi 450 anëtarë.

**Fadil Gashi, kryesues:** Unë personalisht jam për. Urdhëro, Tunë?

**Tunë Deda:** Po, kryesues, e pash kërkesën edhe është kërkesë shumë me vend.

Është mirë të ju dilet në ndihmë sepse është kategori e veçantë, dhe numri i anëtarëve bukur i madh. Komuna i ka disa zyra që i ka të parapara me i dhënë me qira edhe me sjell një vendim në kuvend për me ja dhënë këtyre.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga**



**HANDIKOS për sigurimin e një objekti për plotësimin e nevojave të tyre, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorinë për Administratë.**

**Kërkesa 3.**

Kërkesë e parashtruar nga Alush Asanaj nga fshati Gllarevë, i cili me anë të kësaj kërkesë, kërkon që t'i jepet në shfrytëzim një pjesë prej 3 ari nga parcela me Nr. P-71010034-01074-1, pronë shoqërore e Komunës së Klinës e cila gjendet në rrugën “Abedin Rexha” pa numër. Gjithashtu, thekson se prona në fjalë gjendet afër shtëpisë së tij dhe se planifikon të ndërtojë një objekt për zhvillimin e një biznesi bazuar në kushtet ndërtimore dhe lejen e dhënë ashtu siç përcaktohet me ligj.

**Fadil Gashi, kryesues:** Kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Alush Asanaj, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Pika 8. Të ndryshme.**

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush? Atëherë, faleminderit shumë për pjesëmarrje dhe angazhim!

**Procesmbajtësja,  
Monika Palushi**

**KRYESUESI,  
Fadil Gashi**



**Komuna e Klinës**

**Zyra e kryetarit të Komunës**

01Nr. \_\_\_\_\_ 2024

**Klinë, dt.**

**PROCESVERBAL**

**Nga takimi i kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj me qytetarë, mbajtur me datë 25. 06. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi i cili uroj mirëseardhje të gjithë të pranishmëve në takimin e parë më qytetarë të kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj.

Kryetari Elezaj në vazhdim tha se në pika të shkurtra do të bëjë një përmbledhje të punëve dhe rrjedhjes së parasë publike për këtë 6 mujorin e parë të vitit 2024.

z. Zenun Elezaj, kryetari i Komunës: Ne kemi marrë buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Komunës i cili për vitin 2024 është në vlerë prej 14 milion e 648 mijë e 717 euro. Po jap disa shifra se si kemi ecur me implementimin e kësaj shume. Kategoria paga dhe mëditje është 7 milion e 936 mijë e 857 euro. Nga kjo shume kemi arritur që të shpenzojmë 3 milion e 436 mijë e 934 euro ose 43.93%. Kategori tjetër e rëndësishme është kategoria e projekteve kapitale që në total është e paraparë për këtë vit në vlerë prej 4 milion e 649 mijë e 27 euro dhe prej kësaj shumë janë shpenzuar deri me tani 1 milion e 662 mijë e 223 euro ose 35.75%. Mallra dhe shpenzime, vlera e buxhetit të aprovuar për këtë kategori ekonomike është 1 milion e 742 mijë e 648 euro, ku nga kjo vlerë janë shpenzuar 855 mijë e 614 euro ose 49.1%.

Kryetari Elezaj tregoj edhe për vlerat e shpenzuara në kategoritë e tjera në detaje duke e përmbledhur me grandet që vijnë nga qeveria e që janë 13 milion e 212 mijë e 457 euro dhe që janë shpenzuar 6 milion e 670 mijë e 233 euro. Ndërsa nga të hyrat vetanake të aprovuara 1 milion e 436 mijë e 260 euro janë shpenzuar 324 mijë e 403 euro ose 22.59% tha kryetari Zenun Elezaj. Foli edhe për mjetet e bartura dhe shpenzimet e tyre ku tha se në këtë pjesë ka pas procedura që kanë marrë kohë pasi që ende nuk është marrë aprovimi nga ministria e financave.

“Totali i shpenzimit të buxhetit deri me tani është 42.15 % ndërsa për informim , të hyrat e grumbulluara deri me tani janë 751 mijë e 100 euro dhe edhe pse ende nuk ka përfunduar 6 mujori i parë janë grumbulluar mbi 50% e të hyrave të planifikuara.” e përfundoj fjalën e tij kryetari Zenun Elezaj sa i përket shpenzimit të buxhetit.

Kryetari i Komunës foli edhe për procedurat e prokurimit dhe tha:”Kemi realizuar 58 kontrata prokurimi deri me tani me një sukses të kënaqshëm. Pothuajse e kemi përfunduar vitin buxhetor në lidhje me lidhjen e kontratave. Përgjithësisht mund të them se ky vit shoqërohet me një realizim të

mirë sepse kemi arritur që një pjesë të kontratave të i lidhim me kohë dhe ecuria e dinamikës po ece mirë. Një projekt që do të doja ta theksoi është ai i fundërruesit të ujit dhe ecuria është në nivel të mirë. Duke e pas parasysh nevojën e madhe të qytetarëve për ujë të pijshëm kemi bërë presion tek kompania që ky projekt të përfundoj sa më shpejt. Kontrata ka mbulesë dhe është e paraparë deri në fund të vitit. Përveç kësaj janë edhe disa kontrata të tjera. Projekti i fshatrave lindore të komunës për furnizim me ujë. Projekt i CDI i realizuar dhe tani menaxhohet komplet nga “Hidrodrini” dhe CDI. Janë disa probleme sipas informatave që kam se kompania “Hidrodrini” ka disa pengesa me KEDS në lidhje me largimin e një largpërçuesit. Në pjesën e Budisalcit është i njëjti projekt i ardhur nga CDI ku kam informata se është lëshuar uji , është mbush baseni me ujë dhe tani nisë faza e kycjes së qytetarëve. Kompania “Hidrodrini” do të vazhdoj me montimin e orëve matëse. Një fond është ndarë nga niveli qendror për kycjen e ekonomive në ujësjellës edhe për pjesën e Budisalcit edhe për pjesën e Gllareves ku do të jua mundësoj kycjen pa pagesë në ujësjellës.” tha kryetari Elezaj duke jua dhënë fjalën qytetarëve prezent për bashkëbisedim.

z. Shaban Kuqi, Jashanicë: Janë dy lagje “Veselaj” dhe ”Kuqi”. Kemi mbetur pa rrugë. Kemi qenë tek kryetari na ka premtuar. Janë 150 metra të pa asfaltuara që ka ngel projekti në gjysmë. Po ashtu kemi kërkuar edhe të shtrohet me zhavorr rruga për tek varrezat. Për ujë mos të flasim fare , herë ka herë s’ka fare. Ne i kemi shtëpitë mbi “Shpat”.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Nuk e di që ka ndonjë rrugë pa shtruar në Jashanicë. Më kujtohet kur ju keni qenë tek unë. Më pastaj kam dalë në fshat kam prit që del dikush dhe më orienton por nuk ka dalë askush dhe as nuk kam parë rrugë të pashtuar. Sidoqoftë ne do të dalim prapë dhe do të shohim se ku është ajo rrugë e pashtuar. Asnjë rrugë nuk ka mbet pa shtruar , edhe e juaja do të shtrohet.

z. Shaban Kuqi: Kanë mbet rrugicat pa shtruar.

z. Fehmi Geci: Përshëndetje. Jemi bashkë këtu me banorë të lagjes në rrugën “Azem Desku”. Rruga deri në 2013 ka qenë e kalueshme por në këtë vit ka ndërhy komuna dhe e ka bërë të pa kalueshme. Në zonë urbane me u krijua ky defekt nuk është normale. Konsiderojmë që kryetari i ka këshilltarët e vet, drejtorët dhe do të duhet të jenë më efikas. Kemi pasur një kërkesë ku kësaj kërkesë i është përgjigjur drejtorja e urbanizmit ku na kanë thënë se ajo pjesë i takon “Infrakosit” dhe s’kanë të të drejt të ndërhyjnë. Ne e dimë që të gjitha kërkesat që vijnë në kuvend komunal dhe që i i involvon edhe subjektet e tjera, kuvendoi komunal do të duhej të i shtyj tutje. Mungesa e vullnetit të drejtorisë së urbanizmit për ta takuar përfaqësuesin e “Infrakosit” bazuar në kërkesën tonë për të zhvilluar procedurë për shpallje interes të vecantë të asaj pjese dhe kalimin e saj në pronësi të komunës. “Infrakosi” Pas kërkesës sonë e ka dërguar në Komunë ku ka kërkuar lirimin e pronës së uzurpuar. Pavarësisht prej kësaj Komuna nuk ka marrë asnjë veprim për lirim të asaj prone. Ne kërkojmë që të zbatoni afatet ligjore karshi përgjegjësive që keni. Rruga në kushte dimri nuk funksionon. Shpesh kemi raste kur kërcënohemi edhe me rrezik në komunikacion pasi që ajo rrugë lidhet direkt me rrugën kryesore dhe ka rrezik të krijohet ndonjë aksident fatal. Nuk është projekt shumë i madh që donë angazhim të veçantë, mund të i bashkëngjitet edhe ndonjë projekti tjetër. Ligji jua lejon. Kërkojmë që rrugën tonë ta trajtoni me rishikim të buxhetit.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Sigurisht kërkesa e juaj është shqyrtuar. Ne kemi dalë në teren. Kjo rrugë është e vitit 2013 kur unë skam qenë kryetar komune. Kërkesës suaj ju jam përgjigjur dhe ju kam treguar që aty duhet ndërtuar një muri mbrojtës. Ju kam tregu në telefon gjithashtu se jemi në kontraktim të një kompanie projektuese për këtë rast. Pra, është e nevojshme që të hartohet një projekt për atë rrugë. Brenda muaji do ta hartojmë projektin dhe do ta kemi edhe buxhetin edhe gjitha të tjerat.

z. Hysen Ymeri: Përshëndetje. Unë kaloj rrugës “Martirët e Postaselit” ku kjo rrugë nuk është e shtruar. Është dashtë të shtrohet për hir të martirëve. Publikisht e them se kryetari i komunës nuk është fajtor aspak por ata rreth tij. Ata premtojnë e premtojnë dhe i fshehin ato premtime. Kërkesa e fundit është nga vëllai im. Kjo rrugë është në rrugën për në Gurakoc pasi të kalohet kisha katolike, 135 metra. Sikur mos ta kishte emrin “Martirët e Postaselit” nuk do të ankoheja. Ju bëj thirrje të gjitha partive që të bashkohen dhe përkrahin kryetarin në punët e tij të mira. Ata që e rrethojnë kryetarin nuk po i kryejnë punët qysh duhet, të isha unë kryetar do ti shkarkoja të gjithë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: E di që është ajo rrugë. Me sa kam informata ka pasur pak probleme rreth pronësisë. Këtë vit ajo rrugë do të shtrohet sepse s’ka rrugë në qytet pa shtruar.

z. Lekë Gashi: Përshëndetje. Nuk e di nëse mund të bëjë hajr apo dëm nëse po flas por unë do të i them ato që kam për ti thënë. Sa e pash unë fshati Dobërdol nuk është përmendur askund as në kornizën afatmesme. Të investohet në Binq e të mos investohet në Dobërdol është e pa imagjinuar. Kanalizimi në Dobërdol nuk ka përfunduar. Rrugët e dëmtuara nga kompanitë e ndryshme që kanë bërë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit gjithashtu janë shumë të dukshme. Në fshatin Dobërdol nuk ka përfituar askush nga ndarja e serave. Jam i bindur që secili që ka marr një serë ka pas dike të vetin që ja ka mundësuar. Dobërdoli nuk ka ndriçim publik gjithashtu. Kërkoj që të aktivizohet zyra e gjendjes civile në Ujmir si dhe rregullimin e fushës sportive në Ujmir. Po ashtu dëshiroj të pyes , pengesat që po vendosen në rrugë me çfarë ligji a kriteri vendosen.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne edhe në debatin publik për kornizën afatmesme që kemi pasur në Ujmir, kemi marrë disa kërkesa. Për pak ditë do të instalohet ndriçimi publik, do të rregullohen varrezat. Me sa di që unë para dy viteve kemi shtruar të gjitha rrugicat në fshat dhe gjithashtu kanalizimin e ujërave të zeza. Nëse ka kërkesa për rrugë të reja ta bëjë dikush në emër të fshatit një kërkesë dhe ne do ta shqyrtojmë. Në lidhje me serat , ju tregoj që vitin e kaluar kemi ndarë 100 sera ndërsa kanë qenë mbi 200 aplikacione. E kemi rritë buxhetin dhe të gjithë që kanë aplikuar kanë marrë sera. Më vjen mirë për interesimin e qytetarëve për sera. Problemet e ndarjeve do të mundohemi të i minimizojmë por jua them se ndikimi im është minimal, nuk përzihem në atë drejtim.

z. Lekë Gashi: Nuk thash që ka rrugicë të pa shtruar, thash që kompanitë i kanë dëmtuar rrugët. Kanalizimi është instaluar dhe kryer me mjete vetanake , investime të vet banorëve.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Kur kam ardhur në fshat nuk ka pas nevojë për kanalizim por nëse ndërkohë del nevoja atëherë do ta veprojme gjithsesi.

z. Frrok Palushi, Kryshevë e madhe: Kam një kërkesë për ndriçimin e rrugës në fshat.



z. Zenun Elezaj, kryetar: Është e pamundur që të gjitha fshatrat e komunës të mbulohen përnjëherë me rrjetin e ndriçimit. Do të instalohet edhe në Kryshevë të madhe patjetër.

z. Lekë (pa prezantim), Dresnik: Kam problemin e ujësjellësit dhe askush nuk merret me atë punë. Sot kam qenë të drejtori dhe më tha se mos eja më për këtë punë. S'di me çfarë të drejte më thotë ashtu derisa unë shkoj në emër të fshatit. Ju lutem që të na trajtoni edhe ne sikurse të gjithë të tjerët dhe të kemi ujë. Një problem tjetër është se kapakët e pusëve të kanalizimeve janë vjedhur apo s'di çka dhe kanë mbetur të hapura duke rrezikuar që të bije ndonjëri brenda. Ju lutem gjithashtu që të përdorni autoritetin dhe të merrni masa të rregullohen këto probleme.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Furnizimi me ujë në atë pjesë prej fillmi të Dresnikut ka vështirësi. Kohëve të fundit kompania regjionale i menaxhon kompanitë në komuna. Nëse ka ndonjë buxhet për ujësjellës nuk vjen fare në komunë por shkon direkt në kompaninë rajonale. Ne vjet kemi hy në bashkëfinancim dhe kemi instaluar një gyp me qëllim të rritjes së presionit të ujit dhe të furnizoheni më mirë ju në Dresnik. Unë do të interesohem personalisht që ta takoj drejtorinë e "Hidrodrinit" dhe të ju japim një zgjidhje.

Këtu edhe përfundon takimi i kryetarit me qytetarë të komunës.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryetari:


Zenun Elezaj



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE I NATIONAL AUDIT OFFICE

19-06-2024

Nr. Prot. Br. Prot. Proc. No.	Nr. Faqeve Ds. Stranice Nr. Pages
04 47 886	1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Per:	Glauk Konjufca, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Zenun Elezaj , Kryetar i Komunës së Klinës Fadil Gashi, Kryetarin e Kuvendit Komunal të Komunës së Klinës
Kopje elektronike:	Hykmete Bajrami, Kryetare e KMFP Armend Muja, Kryetar i KBPT
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2023.


Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 19.06.2024
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		<p>Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2023.</p> <p>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.</p>		




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRILIDITJE: ZYRA PËR SHËRIMIN E SHËRIMIT DITË/RECEIVED: ZYRA		19-06-2024	
Nomen. Org. Org. Acctn. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	886	1



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Za:	Glauk Konjufca, Predsednik Skupštine Republike Kosovo Zenun Elezaj, Predsednik Opštine Fadil Gashi, Predsednik Skupštine opštine
Elektronski primerak:	Hykmete Bajrami, Predsednik KNJF Armend Muja, Predsednik KBRT
Od:	Vlora Spanca, Generalna Revizorka Republike Kosovo 
PREDMET:	Izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja za 2023 godinu.

Br. Kancelarije: No. de bureau:	Ext: Poste:	Datum: 19.06.2024
------------------------------------	----------------	-------------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		<p>U prilogu možete pronaći Izveštaj revizije za godišnje finansijske izveštaje za 2023 godinu.</p> <p>Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.</p>		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024



## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

- B1 Komisioni i vlerësimit nuk e kishte bërë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve sipas kritereve të shpallura me thirrje publike.
- B2 Për pagesat në vlerë prej 189,179€ nuk ishin respektuar hapat për procedim të pagesave.
- B3 Mospagesa e obligimeve brenda afatit ligjor 30 ditë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.



Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.



## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikim e shpenzimeve, vlerësimi i aplikacioneve të fermerëve në kundërshtim me thirrjen publike, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Mosvlerësimi i aplikacioneve të fermerëve sipas kritereve të përcaktuar me thirrje publike

#### Gjetja

Sipas dy Thirrjeve Publike për subvencionimin e fermerëve me Makina mbjellëse për misër (11,985€) dhe me Makina mbjellëse për grur (12,190€), midis tjerash kërkohej që përfituesi të jetë banor i komunës, të posedojë sipërfaqe të tokës, të këtë traktor, të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të kostos në mekanizëm bujqësor, përparësi do të kenë fermerët të cilët në tri vitet e fundit nuk kanë përfitua ndonjë projekt nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën, të mos jetë përfitues më shumë se një projekt brenda vitit dhe nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtarë i bashkësisë familjare.

Gjatë shqyrtimit të procesit të vlerësimit të dy thirrjeve publike për subvencionimin e fermerëve me Makina mbjellëse, kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit në formularin e poentimit ka përdorë kritere të cilat nuk kanë qenë të përfshira në asnjërën prej Thirrjeve Publike si: numri i anëtarëve familjar, statusi i punësimit, gjendja ekonomike, ndarja në zonë rurale dhe urbane, posedimi i bunarit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kritereve të shpalljes publike nga ana e komisionit vlerësues.

#### Ndikimi

Subvencionimi i fermerëve duke përdorur kritere të cila nuk kanë qenë të shpallura në thirrje mund ta dëmton transparencën pasi që janë përdorur kritere që nuk kanë qenë të shpallura në Thirrjet Publike, për të cilat aplikuesit nuk kanë qenë të njoftuar.

#### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i vlerësimit do ta bëjë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara me Thirrje Publike.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare

#### Gjetja

Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 24 mostrat e testuara si pjesë e testimeve substanciale në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në nëntë (9) raste në vlerë 189,179€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimet/furnizimet dhe fatura pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

- Ndikimi** Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave**

